



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë

www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: Politika Kriminale

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Politika kriminale
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	2017/2018-Viti i II-të, Semestri i III-të
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6/ECTS
Koha / lokacioni:	Ligjërata: E hënë, 14:00 deri 15:30 Asistent: Dr. Sc. Fatmire Krasniqi
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Sc. Feti Limani, Prof. Ass.
Detajet kontaktuese:	fetilimani@hotmail.com
Qëllimi studimorë dhe përmbajtja e lëndës:	Qëllimi kryesor i studimit të lëndës është që studentëve të Fakultetit Juridik t'ju ofrohen njohuri të përgjithshme në kuadër të lëndës përkatëse. Në lëndën: Politika kriminale, studentët do të kenë mundësi që të mësojnë më detajisht për masat teorike dhe praktike që ndërmerren në shoqëritë bashkëkohore me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit. Para trajtimit të këtyre masave, ata do të njohtohen për veprimet dhe mendimet politiko kriminale lidhur me parandalimin e kriminalitetit që janë paraqitur në formacionet e ndryshme ekonomiko-shoqërore respektivisht të mendimtarët e vendeve representative të këtyre periudhave. Kështu do të mësojnë për pikëpamjet dhe reagimet ndaj kriminalitetit në bashkësinë primitive, shoqërinë skllavoproanre, mesjetë, në kohën e re dhe në periudhën bashkëkohore. Më pastaj do informohen edhe për rolin e organeve të judikaturës dhe të legjislacionit penal në parandalimin e kriminalitetit. Më konkretisht do të njohtohen për rolin e policisë, prokurorit publik, gjykatës dhe organeve për ekzekutimin e sanksioneve penale.
Arritjet e studentit:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje, që të interpretojë dhe trajtojë: 1. Format e reagimit shoqëror ndaj kriminalitetit dhe kryerësve të tij,

	nëpër formacione të ndryshme ekonomiko-shoqërore, duke filluar nga bashkësia primitive e deri në shoqëritë bashkëkohore; 2. Të përshkruajë dhe të interpretojë pikëpamjet politiko kriminale të përfaqësuesve të shkollave juridiko-penale dhe kriminologjike, duke filluar nga shkolla klasike juridiko-penale, shkolla pozitiviste, neoklasike e deri te shkolla sociologjike; 3. Të përshkruajë dhe të trajtojë bazën juridiko-penale të politikës kriminale si dhe teoritë kryesore mbi arsyetimin e dënimit dhe të ndëshkimit të kryerësve të kriminalitetit; 4. Të elaborojë dhe sqarojë rolin e judikaturës penale dhe të legjislacionit penal në rrafshin e parandalimit dhe të luftimit të kriminalitetit në përgjithësi, me një theks të posacëm në shtetin e Kosovës; 5. Të përshkruajë dhe klasifikojë parimet dhe llojet e prevencionit shoqëror si dhe të kuptojë edhe sanksioneve penale. Kurse në rrafshin e legjislacionit penal do të trajtohet ndikimi i <i>Kodit Penal</i>, <i>Kodit të Procedurës Penale</i> dhe <i>Ligjit mbi Ekzekutimin e Sankcioneve Penale</i>, në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit. Po ashtu në kuadër të kësaj lënde do të trajtohen format dhe bartësit e prevencionit të kriminalitetit. Kështu si forma të prevencionit do të studiohen prevencioni i përgjithshëm social, prevencioni i posaçëm social dhe prevencioni individual. Ndërsa prej bartësve të parandalimit të kriminalitetit do të trajtohet, familja si bartësi kryesor, shkolla, mjedisi dhe lagjja, profesioni etj..		
Rezultatet e pritura të nxënies:			
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2		2
Ushtrime teorike/laboratorike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2		2
Kollokfiume,seminare	1		1
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2		2
Përgatitja përfundimtare për provim	2		2
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	1		1
Projektet, seminare, prezantimet ,etj			
Totali	10		10

Metodologjia e mësimdhënies:	1. Metoda e mësimdhënies aktive: Në mbështetje të kësaj metode shpjegohen, përkufizohen nocionet mbi institutet themelore të Politikës kriminale, interpretimi i drejtë dhe i qartë i tyre, e sidomos duke veçuar rëndësinë e jetësimit të parimeve dhe dispozitave tjera. 2. Metoda e mësimdhënies inter-aktive: Zhvillimi i hovshëm i shoqërisë së sotme, si dhe rritja me ritme marramendëse e informacionit, i ndihmuar nga mjetet e shumëllojshme të transmetimit e komunikimit masiv, kanë bërë të mundur që mësimdhënia dhe mësimnxënia të ndryshojë në mënyrë rapide. 3. Metoda krahasuese: Kjo metodë u mundëson studentëve njohjen dhe krahasimin e instituteve më të rëndësishme të Politikës kriminale dhe të sistemit nga fusha e Politikës kriminale e vendeve fqinje në veçanti të Republikës së Shqipërisë dhe më gjërë. 4. Metoda e analizës: Kjo metodë u mundëson studentëve të kuptuarit më fundamental të instituteve dhe parimeve të politikës parandaluese dhe atë duke e bërë zbërthimin, analizën përmajtësore të dispozitave në të cilat përkufizohen parimet kryesore dhe institutet themelore të Politikës kriminale me qëllim të aftësimit të studentëve, që pas përfundimit të studimeve të jenë në gjendje të bëjnë zgjidhjen e çështjeve nga fusha parandaluese jo vetëm në aspektin teorik por edhe në aspektin praktik, në gjyqësinë e vendit. 5. Metoda e studimit të rasteve: Rëndësi të veçant gjatë interpretimit dhe shpjegimit të instituteve themelore të politikës kriminale, ka studimi i rasteve të veçanta nga praktika gjyqësore e vendeve të ndryshme lidhur më zgjedhjet rasteve nga kjo lëmi.		
Përshkrimi i sistemit të notimit:	Studentët i nënshtrohen vlerësimit përgjatë gjithë semestrit. Testi gjysmësemestral dhe ai final mbahen me shkrim. Në vlerësimin përfundimtar përfshihet edhe pjesëmarrja aktive në orën mësimore dhe detyrat e shtëpisë. - Testi gjysmësemestral 30% - Testi final 50% - Aktiviteti në orë (seminar, ese, detyre shtëpie, etj) 15% - Pjesëmarrja 5% Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90= 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50, nuk mbërrijnë/përmbyllin notën kaluese.		
Nota ECTS			
Literatura bazë:	1. Prof. Dr. Vesel Latifi, <i>Politika kriminale</i>, Prishtinë, 2010. 2. Prof. Dr. Ismet Elezi, Prof. Dr. Vasilika Hysi, <i>Politika penale</i>, Tiranë,		

	2001; 3. Prof. Dr. Millan Millutinoviq, <i>Politika kriminale</i> (botim në gjuhën shqipe), Prishtinë.
Literatura shtesë:	1. Prof. Dr. Rexhep Gashi, <i>Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri</i> , Prishtinë, 2001; 2. Prof. Dr. Ragip Halili, <i>Kriminologjia</i> , Prishtinë, 2011; 3. Prof. Dr. Ragip Halili, <i>Penologjia</i> , Prishtinë, 2011; 4. Prof. Dr. Ismet Salihu, <i>E drejta penale</i> , Prishtinë, 2006 dhe 5. Prof. Dr. Haki Demolli, <i>Terrorizmi</i> , Prishtinë, 2002.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	- Njohuritë e përgjithshme mbi politikën kriminale; - Detyra, objekti dhe metodat e politikës kriminale; - Qëllimi i politikës kriminale; - Roli i shkencës së politikës kriminale në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit si dhe - Masat teorike dhe praktike në luftë kundër kriminalitetit
Java e dytë:	- Raportet e politikës kriminale me shkencat e tjera që e studiojnë kriminalitetin; - Politika kriminale dhe e drejta penale; - Raportet e politikës kriminale me kriminologjinë; - Raportet e politikës kriminale me penologjinë; - Politika kriminale dhe e drejta e procedurës penale; - Raportet e politikës kriminale me Kriminalistikën; - Raportet e politikës kriminale me politikën sociale
Java e tretë:	- Zhvillimi historik i mendimeve mbi politikën kriminale; - Format e reagimit shoqëror ndaj kriminalitetit në bashkësinë primitive; - Reagimi shoqëror ndaj kriminalitetit në shoqërinë klasore; - Mendimi politico-kriminal në shoqërinë e vjetër; - Mendimi politico-kriminal në shoqërinë mesjetare si dhe - Mendimi politico-kriminal në kohën e re
Java e katërt:	- Pikëpamjet e shkollave politico-kriminale dhe kriminologjike mbi format e reagimit shoqëror ndaj kriminalitetit; - Pikëpamjet e shkollës klasike juridiko-penale; - Pikëpamjet e shkollës neoklasike; - Pikëpamjet e shkollës positive; - Pikëpamjet e shkollës sociologjike si dhe - Qëndrimet e shkollës së mbrojtjes së re shoqërore mbi kriminalitetin
Java e pestë:	- Mendimet politico-kriminale në shoqërinë bashkëkohore; - Trajtimi i politikës kriminale si disiplinë teorike dhe praktike - Politika kriminale në vendet socialiste të Evropës Lindore;

	- Vështrimi kritik i politikës kriminale si dhe - Parimet e ndërtimit të politikës bashkëkohore kriminale
Java e gjashtë:	- Baza juridiko-penale e politikës bashkëkohore kriminale - Represioni dhe politika ndëshkimore në rrafshin e parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit; - Teoritë e arsytimit dhe të ndëshkimit të kriminalitetit; - Depërtimi i ideve humane krahas atyre jo humane; - Kuptimi i torturës dhe llojet e torturave si dhe - Torturat fizike dhe psikike
Java e shtatë:	Ora e parë: - Gjatë orës së parë do të bëhet vlerësimi i parë intermediar, përmes kollokiumit i cili do të përmbajë deri 20 pyetje që kanë të bëjnë me çështjet e ligjërara në gjashtë ligjeratat e para. Disa pyetje do të jenë të sistemit shumë zgjedhës, disa të tjera sutdenti për t'u përgjigjur duhet të bëjë plotësimet e kërkuara. Ora e dytë: - Tortura elektrike; - Torturat farmakologjike; - Rrahja sistematike dhe mbytja në ujë si forma të torturës fizike si dhe - Privimi si formë e torturës psikike
Java e tetë:	- Judikatura penale dhe funksioni i saj në luftimin e kriminalitetit; - Roli i policisë në luftimin e kriminalitetit - Funksioni i gjykatave në rrafshin e parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit si dhe - Roli i prokurorit në luftimin e kriminalitetit
Java e nëntë:	- Organet e tjera dhe roli i tyre në pengimin e kriminalitetit; - Funksioni i Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues në luftimin e kriminalitetit; - Legjislacioni penal dhe roli i tij në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit; - Ndikimi i Kodit penal në rrafshin e luftimit të krimit; - Ndikimi i Kodit të procedurës penale në rrafshin e luftimit të krimit
Java e dhjetë:	- Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale dhe lufta kundër kriminalitetit; - Roli i sanksioneve penale në luftën kundër kriminalitetit; - Kuptimi dhe llojet e dënimeve; - Dënimet kryesore dhe lufta kundër kriminalitetit; - Rëndësia e dënimeve plotësuese dhe alternative në luftën kundër kriminalitetit
Java e njëmbëdhjetë:	- Parandalimi shoqëror dhe politika kriminale; - Parimet themelore të luftës preventive; - Llojet e prevencionit shoqëror; - Prevencioni i përgjithshëm shoqëror; - Prevencioni individual dhe

	- Prevencioni i veçantë i kriminalitetit
Java e dymbëdhjetë:	Ora e parë: Vlerësimi i dytë intermediar-Pëmes kollokiumit-deri në 20 pyetje Ora e dytë: - Bartësit e prevencionit shoqëror; - Roli i familjes në parandalimin e kriminalitetit; - Roli preventiv i shkollës dhe institucioneve tjera arsimore si dhe - Roli i mjedisit në sferën e parandalimit të kriminalitetit
Java e trembëdhjetë:	- Roli preventiv i përgatitjes, orientimit profesional dhe punësimit; - Roli preventiv i institucioneve të specializuara; - Roli preventiv i ndihmës postpenale; - Ndihma e brendshme dhe e jashtme post-penale; - Roli preventiv i trajtimit individual dhe grupor si dhe - Roli preventiv i organizatave ndërkombëtare
Java e katërbëdhjetë:	- Opinioni publik si faktor i parandalimit të kriminalitetit; - Roli dhe rëndësia e opinionit publik; - Mjetet e informimit publik dhe parandalimi i kriminalitetit; - Rëndësia e studimeve dhe kërkimeve kriminologjike në parandalimin e kriminalitetit si dhe - Politika kriminale bashkëkohore, mjetet dhe metodat e parandalimit të kriminalitetit
Java e pesëmbëdhjetë:	Përsëritje e njësive mësimore, në formë të pyetjeve nga studentët dhe përgjigjeve nga mësimdhënësi dhe anasjelltas.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
- Fillimi dhe përfundimi i orës mësimore në pajtim me orarin dhe informatën për studentët; - Mos përdorimi i telefonit mobil gjatë ligjeratës; - Mospirja e duhanit; - Moskonsumimi pijeve dhe ushqimeve të ndryshme; - Mos të kopjojnë gjatë provimit dhe testimeve të tjera; - Komunikimi civilizues dhe dinjitoz me studentët; - Sigurimi i qetësisë dhe disiplinës gjatë orës së mësimi si dhe - Të dëgjojnë me kujdes si mësimdhënësin ashtu edhe kolegët e tyre.	